

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.18.01.2021*

18.01.2021

Ora 20:00

RENDI I DITËS

Hedhjen e shortit për kërkesat ankimore me objekt:

KA nr1. "Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021" me ankues, Lëvizja Socialiste për Integrim.

KA nr.2 "Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021" me ankues, z. Arben Qalliu, Titullar i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

PJESËMARRJA :

KQZ:

Komisioni i Akimeve dhe Sanksioneve

1.z.Elvis Çefa

2.z.Ledio Braho


Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, z.Olsi Peto

Përfaqësues të partive politike:

1.LSI (z.A.Kaziaj)

Z.Y.Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, sot në orën 20 është caktuar data për hedhjen e shortit pasi në KQZ janë depozituar dy kërkesa ankimore. Sipas nenit 12 të Rregullores së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Pika 6 Hedhja e shortit do të bëhet brenda 12 orëve nga çasti i regjistrimit të kërkesave ankimore. Duke qenë se në ora 20:00 të datës së sotme mbushen 12 orë, ne po hedhim shortin sipas nenit 14 të Rregullores së KAS-it. Mbledhja transmetohet on-line për shkak të covid dhe pa pjesëmarrjen e anëtarëve të KAS-it. Procedura e shortit ndjek këtë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.18.01.2021*

renditje. Në dy shirita letre janë shënuar numrat e kërkesave ankimore, ndërsa tre të tjera janë të bardha. Një punonjës i administratës po ju tregon shiritat e letrës nga ku dy janë të plotësuara, ndërsa tre janë të bardha. Këta shirita futen në 5 gogla me ngjyrë dhe formë të njejtë dhe vendosen në një enë transparente. Pasi vendosen pesë shiritat në pesë gogla në formë dhe ngjyrë të njejtë, vendosen në një enë transparente. Një përfaqësues i administratës së KQZ-së do t'i përzjejë dhe duke qenë se jemi në mungesë të anëtarëve të KAS-it, përfaqësuesja e administratës tërheq sipas rendit alfabetik ngjithës të emrit të anëtarëve të KAS-it, një nga goglat që ndodhet në enën transparente. Sipas alfabetit gogla e parë tërhiqet për zotën Elvin Lako.

1.Tërhiqet gogla për z.Elvin Lako

rezulton e bardhë

2.Tërhiqet gogla për z.Elvis Çefa, **Kërkesa ankimore nr.2** “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, z. Arben Qalliu, Titullar i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”. Zoti Elvis Çefa do të jetë relatori i kësaj kërkesë ankimore.

3.Tërhiqet gogla për z.Ilirjan Rusmajli, **Kërkesa ankimore nr.1** .“Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021” me ankues, Lëvizja Socialiste për Integrim.

5.Tërhiqet gogla për z.Koli Bele

rezulton e bardhë

6.Tërhiqet gogla për z.Ledio Braho

rezulton e bardhë

Në përfundim të shortit të hedhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Kërkesa Ankimore nr.1 do të raportohet nga zoti Ilirjan Rusmajli, ndërsa kërkesa ankimore nr.2 do të raportohet nga zoti Elvis Çefa. Relatori do të caktojë datën dhe orën pasi të njihet me materialet që janë dërguar në adresën e e-mail-it nga Sekretari i Përgjithshëm. Me kaq mbledhja dhe shorti mbyllet, ju faleminderit! **Vendimi nr.8**

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*

